



Titulli i projektit

Sistemimi i bregut të Liqenit dhe përshtatja në pikë turistike

Tipi i projektit

Mjedisor / Turistik

Vendndodhja e projektit

Zona Funksionale Kukës

Buxheti i paravlerësuar

150,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Liçeni i Fierzës është liçeni artificial më i madhi në vend. U krijua në vitin 1978, mbi Lumin Drin për krijimin e HEC të Fierzës. Ai shërben si një lidhëse mes Kukësit, Tropojës dhe Hasit. Ky Liçen, përveç shfrytëzimit për industrinë energjitike, ka edhe funksion turistik. Ai rrethon qytetin e Kukësit nga tre anë, duke të krijuar përshtypjen e një gadishulli. Me shpalljen e tij Park Natyror Rajonal, është e rëndësishme që Liçeni të shfrytëzohet në mënyrë sa më eficiente, që përfitimi të jetë i dyanshëm. Sistemimi i bregut është një hap që i shërben mirëmenaxhimit. Kjo sepse në stinën e verës bregu shfrytëzohet nga banorët e zonës për turizëm balnear dhe peshkim. Gjithashtu, përgjatë bregut gjenden edhe biznese familjare, që ofrojnë pushim të këndshëm dhe ushqim tradicional bio. Aktualisht vërehet një kërkesë në rritje për të vizituar këtë potencial natyror të pashfrytëzuar nga banorët, si dhe një interes i shtuar nga pushteti vendor për ta shndërruar në një destinacion turistik.

Qëllimi/et specifik të projektit

OS1: Të shndërrohet bregu i Liqenit në një ambient të pastër, të bukur, çlodhës dhe mbi të gjitha të kthehet në një destinacion turistik.

OS2: Të kthehet bregu i Liqenit në shërbim të komunitetit, duke ndikuar në rritjen e bizneseve të vogla që ushtrojnë aktivitet në fushën e lundrimit, peshkimit, shërbimeve ambulante, etj..

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

R1: Ambienti në bregun e Liqenit është bërë më i këndshëm dhe tërheqës për turizëm

R2: Mundësi më të mëdha për ushtrim aktiviteti të bizneseve të vogla lokale

R3: Rritje të numrit të vizitorëve dhe turistëve

R4: Rritje të ardhurash me 15%

PROJEKTI 5



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

1. Përcaktimi i vijës së bregut për destinacion turistik dhe studimi i ndërhyrjeve të lejueshme
 2. Pajisja me objekte dhe mjete të nevojshme
 3. Mbushja e një vije bregu me rërë plazhi
 4. Blerje varkash të vogla turistike
 5. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes partnerëve
 6. Dizajni dhe publikimi i 2000 fletëpalosjeve
 7. Publikim në median vizuale
- Projekti mendohet të zbatohet në një periudhë 2-vjeçare

Maturimi i projektit

Nuk ka studime të mëparshme në këtë drejtim. Si fillim lind nevoja për një takim me grupet e interesit dhe banorët që preken nga ujërat e Liqenit të Fierzës, për t'i informuar dhe për të marrë idetë e tyre. Më pas duhet të kryhet një studim, i cili do të jetë dhe në kuadër të planit të menaxhimit të Liqenit të Fierzës si Park Natyror Rajonal. Ky studim duhet të përcaktojë llojet e ndërhyrjeve, si: bizneset, vendet e shfrytëzimit për turizmin balnear nga banorët, zonat që do të mbrohen, etj..

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Nuk ka burime të evidentuara ende
Projekti do të zbatohet nga:

- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukës.
- Këshilli i Qarkut Kukës
- Bashkia Kukës

Kostot e projektit

Përcaktimi i vijës së bregut për destinacion turistik dhe studimi i ndërhyrjeve të lejueshme 20,000€
Pajisja me objekte dhe mjete të nevojshme 70,000€
Mbushja e një vije bregu me rërë plazhi 40,000€
Blerje varkash të vogla turistike 16,000€
Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes partnerëve 0€
Dizajni dhe publikimi i 2000 fletëpalosjeve 2,000€
Publikim në median vizuale 2,000€